

VENDIM
Nr. 1029, datë 16.12.2020

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”, TRUALL, TË NJË SIPËRFAQEJE NË PASURINË ME NUMËR 16/15, ZONA KADASTRALE 3361, BASHKIA PATOS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, për sipërfaqen prej 1750 m², pjesë e pasurisë me numër 16/15, zona kadastrale 3361, Bashkia Patos, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Fier, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, për sipërfaqen ndërtimore sipas lidhjes nr. 1, të pasurisë me numër 16/15, zona kadastrale 3361, Bashkia Patos.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Fier dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

Nr. rendor	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja m ²	Sipërfaqja ndërtimore m ²	Emërtimi i strukturës
1	Fier	Patos	3361	Sheqishte	16/15	4000	1750	Objekt 1-katësh për grumbullimin e produkteve bujqësore



